



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 22.4.2024, duke filluar në orën 10:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Milazim Vitija, Jeta Rafuna,, Shegë Beqiri, Leutrim Retkoceri, Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi dhe Mirsad Vitia.

**Mungoi:** Bahri Gashi.

**Në mbledhje ishin të pranishëm edhe:** Përparim Rama, Kryetar i Kryeqytetit, Osman Bllaca, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Adelinë Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Social, Valbona Ahmeti-Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencia dhe Arben Kqira, udhëheqës i Zyrës ligjore.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Fehmi Kupina, kryesues i Komitetit, me këtë:

### REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 mars 2024 (TM 1);
3. Plani vjetor i punës së Kuvendit për vitin 2024;
4. Propozim-vendimi për marrëveshje-kornizë të bashkëpunimit ndërkomunal shumëfunksional ndërmjet: Kryeqytetit të Republikës së Kosovës-Prishtinës, Komunës së Podujevës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Fushë-Kosovës, Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Obiliqit;
5. Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Qendrës sociale edukative “Don Bosko”;
6. Propozim-vendimi për fillimin e procedurave të konsultimit publik për Projektregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01 nr. 110-1203, dt. 16.6.2010;
7. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për dy familje strehuese, Sinani dhe Selmani;
8. Propozim-vendimi për mbështetje financiare të shërbimeve sociale për fëmijë me aftësi të kufizuara;
9. Propozim- vendimi sipas të cilit duhet të mirëmbahen të gjitha hapësirat publike ose private, vizuelisht të dukshme nga rruga, apo të cilat ndikojnë në mjedisin përreth, në pamjen vizuele dhe të pastër të Kryeqytetit;

## 10. Diskutim lidhur me zyrtarizimin e Parkut memorial “ Të Pagjeturit”.11,

### 11. Të ndryshme.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, **Gëzim Sveçla** propozoi pikë shtesë: “Propozim – vendimi për plotësimin – ndryshimin e Vendimit, nr. 01-020/02-103516, për themelimin e komiteteve të tjera”, do të thotë është çështje teknike, vetëm kemi me ndërruar një asamblist.

**Mirsad Vitija;** u shpreh se pasi qenka mbledhja e dytë e rregullt e Komitetit për Politikë e Financa, po më intereson të dijë se pse nuk është sjellë në këtë mbledhje raporti financiar për vitin e kaluar, meqenëse nuk është diskutuar fare po besojë, që do të duhej të trajtohej.

**Valbona Makolli:** dha sqarime, duke thënë se raporti financiar vjetor, TM 4, sipas rregullores së Ministrisë së Financave, nuk kërkohet të diskutohet, përkatësisht të publikohet deri më 30 janar të secilit vit, meqenëse nuk janë mbajtur mbledhjet, ato janë publikuar në afatin e kërkuar nga Ministria e Financave. Nëse Kuvendi është i interesuar të diskutojë se çfarë ka ndodhur, ose me pa atë raport, për ne nuk është problem, materiali është në zyrën e Kuvendit qysh para përfundimit të periudhës kohorë, ku Ministria e Financave iu kërkon të gjitha komunave, dhe është publikuar me kohë. Nëse duhet diskutua ne e diskutojmë, por komplet materiali është në zyrën e Kuvendit.

**Gëzim Sveçla:** ceku se është gjithmonë praktikë që e kemi diskutuar raportin e vitit paraprak, sepse aty nuk mjafton vetëm me publikuar në ueb-faqe, sepse mund të kemi vërejtje, paqartësi ndoshta, ku të cilat vazhdimisht janë diskutuar, është edhe pjesë e planit të punës së Kuvendit, ku gjithmonë kemi diskutua shqyrtimin e raportit financiar të vitit paraprak, tani është vonë për me e futur në mbledhjen e cila është pasnesër. Unë e mendojë se duhet të futet si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës.

**Valbona Makolli:** tha se nuk është problem, kurdo që e shihni të arsyeshme, unë jam e gatshme.

**Kryetari:** theksoi se raportin e kryetarit e kisha propozuar me e futur nëse jeni në rregull, kjo është një. Është edhe e dyta, një propozim apo bashkëpunim ndërkomunal, është vetëm një iniciativë, faktikisht me votuar dhe me dërguar përpara, e cila është votuar prej komunave të tjera, kjo është me rëndësi të madhe për Kryeqytetin, për Obiliqin, Vushtrrinë, Podujevën, Mitrovicën, për me bërë këtë ndërlidhjen vetëm si iniciativë, kisha propozuar me e futur si iniciativë nëse jeni në rregull. Përndryshe, mundemi të iniciojmë edhe seancën e radhës menjëherë, brenda një kohe të shkurtër, ku mundemi me i futur këto, por po e them e ngrita si një çështje, po them se mundemi me futur tash, mirëpo mundemi edhe me organizuar një seancë të radhës.

**Kryesuesi:** tha se e kam menduar qysh të enjten me përcjellë për seancë të radhës, që me pasur mundësi me i mbajtur dy seanca brenda muajit, ose majit, si të doni, nuk ka problem. Kam menduar se këto pikat të cilat nuk janë futur, me i fut në seancën e radhës, diku më 14 me u mbajtur seanca tjetër, pastaj më 31 maj tjetrën me i zënë afatet se nuk mundesh ndryshe.

**Kryetari:** theksoi se më 14 nuk gjendet këtu, do të jetë në Pragë në një takim me kryetarin e Pragës,

**Kryesuesi:** u shpreh se pse nuk ka mundësi, nëse e shtyjme nuk mund të mbajmë seancë tjetër, tani edhe janë festat, i kemi shikuar të gjitha dhe është pak problem.

**Nora Kelmendi:** tha se e kemi ne një marrëveshje, a ishte kjo marrëveshje Podujevë, Lipjan a është kjo tjetër?

**Kryetari:** bëri të ditur se kjo është tjetër, për inicim kjo është shumë e thjeshtë, vetë për inicim të kësaj iniciativës me u lidhur me një rrugë që e lidhë Prishtinën, Obiliqin, Podujevën dhe Mitrovicën, është iniciativë faktikisht që është nënshkruar prej të gjitha komunave të tjera dhe duhet të nënshkruhet edhe nga Komuna jonë.

Atëherë po e fusim këtë bashkëpunim ndërkomunal, e për raportin nëse mundemi me e ndërruar datën.

**Gëzim Sveçla:** u shpreh se mundemi me dërgua më herët ftesën për seancë, se raporti i punës së kryetarit pa kryetarin nuk bëhet.

**Osman Blaca:** propozoi më 31 maj.

**Kryetari:** tha në rregull, ose mundemi tash, se raporti është publik prej shumë kohësh, raporti ka qenë publik që një kohë të gjatë edhe po raportoj çdo ditë për punë.

**Lulëzim Fushtica:** propozoi nëse jo në këtë takim, me futur pikën “Plotësim-ndryshimin e raportit për vlerësimin e dëmeve”, mbetet kërkesa e juaj, është plotësuar, është ndryshuar, janë rishikuar të gjitha ankesat që i kanë pasur edhe qytetarët, edhe anëtarët e respektuar të Kuvendit, raporti është gati, nëse ju e shihni të arsyeshme për këtë mbledhje mirë, nëse jo ose mundemi në takimin e radhës, mundemi me ua dërguar edhe një herë raportin për me shikuar.

**Leutrim Retkoceri:** pyeti kryesuesin se kur mendoni me e thirre mbledhjen e dytë.

**Kryesuesi** tha më 14 maj, e para vjen pasnesër, e dyta më 14 maj.

**Leutrim Retkoceri** :pyeti se a mundesh me e caktuar më 10 maj.

**Kryetari:** u pajtua nëse mund të caktohet më dt. 10 maj.

**Kryesuesi** : tha nëse pajtohen të gjithë.

**Luljeta Selimi** :pyeti se pse mos të futet Raporti i kryetarit, pasi e ka të gatshëm dhe është i publikuar në ueb- faqen e Komunës.

**Gëzim Sveçla:** u përgjigj se Raporti i kryetarit, duhet me u analizua, sepse është raporti kryesor i institucionit më të lartë në vend.

**Jeta Rafuna:** pyeti se a po mendoni me mbajtur më 10 maj.

**Kryesuesi:** tha se e përkrah nëse pajtohen të gjithë për këtë datë.

**Kryetari:** tha se atëherë mundemi me lënë, Kryetar po mbetet më dt. 10, nëse ju i sillni materialet menjëherë.

**Gëzim Sveçla:** tha pse nuk po e leni më dt. 13, është më mirë, po mendojë se e lidhin shqiptarët, këtë 9 dhe 10 lidhet vikendi, nuk keni me pasur asamblistë.

**Kryesuesi:** tha si të koordinoheni unë nuk e kam problem. A e lëmë më 8 maj? Tash e shikojmë vetëm afatin ligjor, nëse pajtohemi të gjithë, vetëm ju kisha lutur që mos me e lënë në KPF me i sjell materialet, dërgoni materialet me kohë.

**Gëzim Sveçla** :pyeti se a po i votojmë këto propozime.

**Jeta Rafuna:** propozoi futjen e një pike të rendit të ditës për Komitetin për Politik dhe Financa, sepse anëtarja jonë Donjeta Dragusha, tash ka kaluar si drejtoreshë e Bujqësisë dhe e ka liruar mandatin, kështu që të propozojmë anëtare nga LDK-ja.

**Leutrim Retkoceri:** u shpreh se edhe një diskutim tjetër, një propozim, me pikën 2 të raportit financiar, në kushte normale është dashur me qenë në seancën e parë, pavarësisht se publikohet edhe nuk ka logjikë me u diskutuar TM1, i 2024 e mos me qenë pikë e raportimit TM4 i vitit 2023. Nëse fillojmë me diskutuar TM1, të 2024-ës e me anashkaluar TM4 të 2023-ës, i bie pak mbrapshtë.

**Valbona Makolli:** dha sqarime, duke thënë se është konsultuar me kryesuesin. A bën me publikur qysh është sipas planit që e kemi në Kuvend, ai më ka thënë po. Për me diskutuar e diskutojmë kur të jeni në gjendje, nuk është problem, mirëpo unë e kam respektuar rregulloren që është, për këtë muaj e kam pasur TM1, pa e anashkaluar atë unë e kam pasur materialin, por nuk është mbajtur mbledhja. Materiali është i gatshëm në kohën kur e kërkon Ministria e Financave, përndryshe edhe në këtë mbledhje futeni, unë jam e gatshme kur të doni.

**Leutrim Retkoceri:** falënderoi drejtoreshën Valbona, është çështje e raportimit, është mirë me shkuar mbarë raportet financiare, mirë që e keni publikuar, por po mendojë që më e qëlluar është me qenë TM4, i 2023-ës, me hi pas kësaj mbledhje për mbledhjen e ardhshme, pas këtij takimi, e ky me u shty për mbledhjen e ardhshme.

**Mirsad Vitija:** tha d.m.th. 3 raporte, TM4, është komplet viti 2023 edhe ky raporti aktual, 1 janar deri më 31 mars.

**Gëzim Sveçla:** pyeti drejtoreshën se a është në rregull nëse mbeten këto të tria.

**Kryesuesi:** tha se pika e dytë largohet nga rendi i ditës.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e **Gëzim Sveçles** për Propozim-vendimin për plotësim-ndryshimin e vendimit nr. 01-020/02-103516, për themelimin e komiteteve të tjera, do të thotë, është çështje teknike vetëm kemi me ndërruar një asamblist.

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri u përkrah ky propozim.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e kryetarit “Propozim-vendimi për nismën e kryetarit për të hyrë në bashkëpunim ndërkomunal”.

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri u përkrah ky propozim.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e Jeta Rafunës, “Propozim-vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për themelimin e Komitetit për Politik dhe Financa”.

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri u përkrah ky propozim.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e Leutrimit për tërheqjen e pikës së dytë “Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 janar - 31 mars 2024 (TM 1).

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri u përkrah ky propozim.

#### **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë e Financa.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë e Financa.**

#### **Pika e dytë**

**Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 janar - 31 mars 2024 (TM 1).**

**Kjo pikë u hoq nga rendi i ditës.**

#### **Pika e tretë**

**Plani vjetor i punës së Kuvendit për vitin 2024.**

**Gëzim Sveçla** :shprehu mendimin se është pak problematike për të votuar këtë plan të punës, për arsye se kanë kaluar 3 muaj dhe nuk kemi pasur mundësi me realizua këtë plan, se nuk kemi mbajtur mbledhje dhe normal nuk është realizuar. Unë mendojë se ndoshta duhet bërë një rifreskim të planit, në mënyrë që pikat të cilat kemi pasur me i diskutuar në 3 seancat paraprake, që është dashur të mbahen deri tani, me i inkorporua në pjesën e mbetur të vitit. Andaj, mendojë se është mirë jo këtu, po në seancë me ndodhur propozimi që me u formua edhe njëherë grupi dhe me i shikuar këto pikat të cilat kemi pasur me i diskutuar.

**Jeta Rafuna**: u shpreh e pajtimit me z. Sveçla, në rrethana qysh është formuar edhe komisioni nuk kanë qenë të përfshira të gjitha, grupet e asamblistëve, një mbledhje është mbajtur, nuk e di sa ka qenë funksionale, mendojë se duhet në seancë me u formuar komisioni, me u votuar edhe një herë dhe me vazhduar me bërë një plan që na plotëson të gjitha kërkesat tona.

**Leutrim Retkoceri**: sugjeroi që deri në seancë me i sjellë rekomandimet komisioni, një draft tjetër me u prezantuar, mandej grupet me i dhënë komentet edhe vërejtjet në seancë. Është logjike kjo që muajt janar, shkurt dhe mars, ki pika që më nuk janë valide dhe nuk mundesh me i votuar, diçka retroaktiv që ka ecur, nuk munden me u aprovuara si të përfunduara pa u përfunduar. Do të duhej që komisioni me formuluar edhe njëherë draftin, grupet me i dhënë komentet për me u votuar.

**Gëzim Sveçla**: përkrahu propozimin e z. Retkoceri, por nuk e di a mundet nesër me u thirr ky komision, është komisioni aktual, e kemi votuar për këtë plan.

**Luljeta Selimi** :theksoi se për këtë plan mund ta ftoni komisionin e kaluar.

**Kryesuesi** :po ai është komisioni, i vjetër, i ri, ai është aktual.

**Gëzim Sveçla**: pyeti se a mund të ftohen për nesër, që me na u prezentuar në seancë këto ndryshime.

**Luljeta Selimi**: tha se mundemi tash, nesër derisa të na përgjigjen anëtarët e komisionit.

**Osman Bllaca**:tha se ne nesër takohemi, po i bëjmë ndryshimet edhe tani në seancë.

**Kryesuesi** konstatoi se u përkrah **Plani vjetor i punës së Kuvendit për vitin 2024** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### **Pika e katërt**

**Propozim-vendimi për marrëveshje-kornizë të bashkëpunimit ndërkomunal shumëfunksional, ndërmjet: Kryeqytetit të Republikës së Kosovës - Prishtinës, Komunës së Podujevës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Fushë-Kosovës, Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Obiliqit.**

**Kryetari:** dha sqarime lidhur me këtë pikë, duke thënë se kjo është një iniciativë që e kemi marrë më 11 mars të vitit 2022, ku e kemi pasur edhe konferencën a parë me komunat dhe jemi marrë vesh që të kemi një bashkëpunim të ndërsjellë për çështjet të cilat janë të përbashkëta, si p.sh. problemi me qentë endacakë, për aspektin e trafikut urban, për një numër të madhe të funksioneve të ndryshme që i kemi të përbashkëta në mes të gjitha komunave. Është një gjë që është votuar në të gjitha komunat e tjera, e pret edhe votimin tonë, ne si iniciator, d.m.th. kjo është për çka po votohet, me zbrit prej nivelit të kryetarëve në nivel të drejtorive.

**Gëzim Sveçla:** u shpreh se ato që i tha kryetari, problematike pak, se gjithmonë po mbesim kështu, Komuna e Prishtinës e fundit me i votuar, ndërsa komunat tjera me i votuar, por shpresojmë me përmirësua këtë lloje te praktikës, me qenë shembull për të tjerët.

**Leutrim Retkoceri** :tha se në rregull është, bashkëpunim shumë funksional, a kryen punë edhe për punë të tjera si kjo e rrugës, apo duhet të trajtohen veç e veç në Kuvend nismat ndërkomunale, se ky, si e pashe unë, si material ka pasur mundësi me shërbyer edhe për iniciativën tjetër, se është për të njëjtat komuna, nëse ndryshojnë komunat.

**Kryesuesi** konstatoi se u përkrash **Propozim-vendimi për marrëveshje-kornizë të bashkëpunimit ndërkomunal shumëfunktional ndërmjet: Kryeqytetit të Republikës së Kosovës-Prishtinës, Komunës së Podujevës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Fushë-Kosovës, Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Obiliqit** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

### **Pika e pestë**

**Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Qendrës sociale edukative “Don Bosko” në Prishtinë.**

**Doruntinë Maloku** tha se si fillim më lejoni me iu propozuar me ndryshuar pikën e rendit të ditës, sepse është propozim-vendimi me vazhduar kontratën e shfrytëzimit e jo dhënie në shfrytëzim. D.m.th. jo si procedurë e rregullt, pra “Propozim-vendimin per vazhdimin e kontratës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës për qendrën edukative “Don Bosko””,

Atëherë, siç e dini, “Don Bosko” ka vite të tëra që e shfrytëzon pronën komunale dhe vitin e kaluar i ka skaduar kontrata e shfrytëzimit. Fillimisht e ka marrë një caktim të lokacionit nga Kuvendi komunal, kryetari i ka kërkuar ish-drejtoreshës së Arsmi, znj. Donjeta Sahatçiu, që Drejtoria e Arsimit ta bëjë një vlerësim të performacës, ashtu siç e kërkon ligji për dhënie në shfrytëzim. Drejtoria e Arsimit e ka bërë një raport, ku e ka bërë vlerësimin e performacës, vlerësim pozitiv për performancën e shkollës “Don Bosko” dhe kështu kryetari propozon që kontrata t’i vazhdohet edhe për 5 vjet të tjera “Don Bosko”. Pra, kjo është çështja jo për dhënien në shfrytëzim, por jo si procedure e re, por kontrata që është aktuale me qenë se i ka skaduar në bazë të performacës ashtu siç kërkohet edhe me ligje të vazhdohet.

**Nora Kelmendi** tha se herën e kaluar e kemi pasur këtë propozim, por nuk kaloi në KPF dhe u morëm vesh me Doruntinën dhe të tjerët, për këto ndërtesa të bëhet pranimi teknik, me e sjellë dokumentacionin për pranimin teknik, për këtë arsye edhe nuk shkoi në Kuvend.

Unë i kam disa pyetje për këto objekte. Pasi që nuk e keni sjellë kërkesën për pranim teknik ashtu si jemi marrë vesh herën e kaluar, këtu janë 6 objekte. Nuk e dimë a kanë leje apo nuk kanë leje të përdorimit, në mënyrë që me u regjistruar në Kadastër. Sigurisht që kur e jepni pronën në shfrytëzim, ju duhet me regjistruar edhe objektin. Tash e kam një pyetje, këtë marrëveshjen e re që e keni, çka ka me ndodhur me ato objekte, a kanë me i mbetur Komunës, apo “Don Bosko” e merr obligimin, kjo varet nga kontrata, si e bëni ju marrëveshjen. Monitorimi paska ndodhur, po thoni se e keni marrë prej Drejtorisë së Arsimit”, njëfarë performance, një vlerësim të performacës, por ne si asambleistë nuk e kemi parë. Nuk e keni pru lëndën, certifikatën e pronës edhe në lëndë e kemi propozim-vendimin edhe vendimin.

**Doruntinë Maloku** bëri të ditur se ky propozim ka ardhur nga Zyra ligjore, për shkak se Zyra ligjore e ka vazhduar si proces të vazhdimit të kontratës, edhe Zyra ligjore e ka marrë raportin, unë e kam printuar dhe prej emailit është dërguar tek ju.

**Nora Kelmendi** theksoi se këtu janë edhe asamblistët e tjerë, mua më kanë ardhur vendime, propozim-vendime dhe certifikata e pronës, po ashtu pyeti se a mundesh vetëm me na u përgjigjur në pyetjen për pranimin teknik, qysh kemi biseduar herën e kaluar.

**Arben Kqira** u përgjigj në pyetjen e parashtruar nga parafolësja.

**Nora Kelmendi** u shpreh se si jurist po ju pyes një pyetje kështu, se unë nuk jam juriste. A ka pasur të drejtë “Don Bosko” me i bërë ndërtimet në vitin 2018, në tokë të Komunës ka ndërtime të reja.

**Arben Kqira** tha se unë nuk e di që ka ndërtime pas vitit 2018, deri në vitin 2018, e ka pasur ai tjetri kontratën.

**Doruntinë Maloku** dha sqarime shitesë lidhur me procedurat.

**Nora Kelmendi** tha se atëherë mbetet që nëse e japim në shfrytëzim edhe e kryeni kontratën, patjetër duhet me u regjistruar në këtë parcelë, si shfrytëzim 50 vjet, në kadastrë, se zakonisht nuk po i regjistroni, Nëse nuk e regjistroni nuk mundet me bërë as pranimin teknik, se nuk është në emër të vet.

**Doruntinë Maloku** tha se kjo është e vërtetë.

**Kryetari** thekso se jo vetëm me regjistruar, por duhet me pasur edhe një klauzolë, se çka mundet me ndodhur me këto ndërtesa pas 50 vjetëve, se faktikisht këto duhet me ardhur te Komuna, këto probleme ne po i shohim, në kontrata të tjera, në këtë rast nuk duhet bërë këtë lëshim për këtë arsye. E shohim me rëndësi shumë të madhe pse duhet me votuar këtë për me investuar, është punë që duhet me investuar në çështje të edukimit, se ju duhet pas 50 viteve, në bazë të raportit të drejtorisë, jemi të kënaqur me shërbime të tyre dhe faktikisht, na ndihmoni.

**Nora Kelemndi** tha se nuk po e kontestojmë, as votimin as këtë çështje, por kemi dashur me qenë në rregull me procedura.

**Gëzim Sveçla** pyeti se a ka mundësi me na dërguar atë raport se nuk është në e-maila raporti, nuk e di ku e ke marrë, prej kujt e ke printuar.

**Doruntinë Maloku** pohoi se e kam marrë prej Arbenit.

**Nora Kelmendi** tha se nuk na e kanë dërguar neve.

**Arben Kqira** e mori për obligim për t’ua përcjellë në e-mail.

**Doruntinë Maloku** bëri të ditur se kjo procedurë për vazhdimin e kontratës është zhvilluar nga Zyra ligjore, Zyra ligjore e ka marrë raportin dhe e ka dërguar në Shërbimin e Kuvendit, nuk e ka dërguar Drejtoria e Pronës.

**Kryesuesi** theksoi se te ne nuk e ka dërguar.

**Gëzim Sveçla** tha ne nuk e kemi atë material, tjetër send është nëse na dërgoni, se materialin nuk e kemi, raportin nuk e kemi. Doruntinë a po e konstatojmë që nuk e kemi raportin?

**Doruntinë Maloku:** tha publikisht, dëgjomë vetëm pak Gëzim, si procedurë për vazhdimin e kontratës është dorëzuar nga Zyra ligjore, dhe Zyra ligjore e ka marrë raportin dhe e ka dërguar në Shërbimin e Kuvendit, mua mi ka dërguar Drejtoria, dhe atë e-mail e printova nga Zyra ligjore, ku e ka dërguar në Kuvend në dhjetor të vitit të kaluar, ku edhe i kemi diskutuar këto çështje, kështu që kjo është situata për “Don Bosko”. Sinqerisht ju lus t’i japim një zgjidhje, kemi kërkesa edhe vizita të përditshme me përfaqësues të qendrës “Don Bosko”, ata kanë bërë një investim të madh, performancën e kanë shumë të mirë, natyrisht se ne i kemi kushtet tona, edhe ata duhet me iu përmbajt kushteve.

**Gëzim Sveçla** i parashtroi pyetje Zyrës ligjore. Neni 13, te publikimi i listës së pronave që ka të bëjë me këtë rast, a mundesh veç me na dhënë interpretimin tënd, edhe neni 4, të jetë e regjistruar si pronë e Komunës në regjistrin kadastral të pronës. Ne çka po kërkojmë ligjshmëri edhe respektim të procedurave, në mënyrë që mos me qitë në lajthitje as asamblenë, qysh ka rënë disa here, e as mos me ndodhë që me ardhur pastaj me ta kthyer një opinion negativ për këtë vendim. Janë dy nene të kësaj procedure, të cilat nuk janë plotësuar me dokumentacione që na u është ofruar neve. Ky është qëllimi. Po mendoj se është e rëndësishme me na dhënë një opinion si Zyrë ligjore për të dyja neni 13 i Ligjit dhe neni 4 i Rregullores, neni 4 pika 1.1. Regjistrimi i pronës së Komunës. Po ashtu, pyeti se a mundem me konstatuar se ky nen nuk është në rregull, nuk është plotësuar në këtë rast me dokumentacione, se këtu ka prona.

**Arben Kqira** theksoi se prona është e regjistruar në emër te Komunës.

**Gëzim Sveçla** parcela nuk shkon ndaras, a po ia marrim ne ndërtesat a po ia vazhdojmë edhe ndërtesën me parcela,

**Arben Kqira** dha sqarime për çështjet e parashtruara nga parafolësi.

**Gëzim Sveçla** u shpreh se nuk kemi dyshim që do t’i rregullojmë, mirëpo në këto kushte që jemi, ky nen, kjo pikë nuk është në rregull.

**Kryetari** dha sqarime se problemi është, në njërin anë nuk mundet me u lëshuar leja ose kushtet teknike, sepse nuk është e regjistruar prona, në anën tjetër nuk mundet me u regjistruar prona sepse nuk i ka kushtet teknike. Për këtë arsye është ky propozimi i radhës që kemi bërë, me regjistruar me ia dhënë një periudhë kohore për me i përmbushur pikat që me u hequr prej këtij stagnimi, për shkaqe të këtyre neneve, dhe mendoj që kjo është mënyra më e mirë për me e shty përpara, sepse kështu nëse kështu kishte me mbetur për jetë nëse nuk marrim një veprim të tillë.

**Gëzim Sveçla:** tha është një problem këtu kryetar, që asnjëherë këto kontratat të cilat ti i bënë, pastaj qysh është e rregulluar me ligj, domethënë nuk po dua ta kontestoj këtë të drejtë që ta jep ligji. Asnjëherë, në asnjë asamble nuk i shohim, negociimin e kontratave që e bënë me palë në raste kur jepet prona në shfrytëzim.

**Doruntinë Maloku** tha se dhënia në shfrytëzim, kontrata bëhet si pas vendimit të Kuvendit, ndërsa negociimi i kontratës, për çka po flisni ju, ajo negociohet në ofertën e negociuar, që vjen po ashtu në asamble, që duhet me ardhur para se me u votuar.

**Gëzim Sveçla** tha se a po thua që pasnesër ka me na ardhur kontrata, ku kryetari tregon sa është afati ligjor që "Don Bosko me i plotësuar kushtet teknike.

**Doruntinë Maloku** tha po, nëse mundet zyra ligjore me ndryshuar propozim-vendimin e bën.

**Gëzim Sveçla** tha diçka tjetër është propozim-vendimi, ne deri tash folëm se në kontratën të cilën ka me negociuar kryetari, ka me ia imponuar si kusht që me një afat ligjor.

**Doruntinë Maloku** tha se kryetari këtë kontratë nuk e negocion, këtë po dua me thënë, nuk e negocion, nuk ka lidhje negociim me atë që po flasim ne. Kryetari nuk ulet me negociuar me "Don Boskon" qysh me ia bë kontratën, Komuna vetë i përcakton kushtet qysh me i dhënë për shfrytëzim, nuk e negocion.

**Gëzim Sveçla** tha me të njëjtën rregullore është dhënë edhe "Sunny Hill" edhe kjo.

**Doruntinë Maloku:** e njëjta rregullore i bëjnë dy procedura të ndryshme!

**Gëzim Sveçla** pyeti ke kontrata e cila ka me u bërë me dhënë "Don Bosko" në shfrytëzim ose me ia vazhduar, a ka me u bërë kontratë, nëse po. atë kontratë kush e sheh, se ne e shohim veç një vendim, që e merr asambleja pasnesër.

**Doruntinë Maloku** tha se ju e keni të drejtën e botës me pa kontratën, askush nuk ta konteston këtë çështje, veç po them që negociimi nuk bëhet për këtë lloj kontrate, kjo është kushtet që i paraqet Komuna në kontratë për me marrësin si shfrytëzim, ndërsa procedura e negociimit direkt te kryetari, si në rastin e "Sunny Hill" është proces i ndryshëm.

**Gëzim Sveçla** pyeti se çka thotë ligji për afatin 15 deri 99 vjet, ku po hyn edhe kjo, se kjo po jepet për 50 vjet.

**Doruntinë Maloku** tha kjo është për vazhdim të kontratës, ligji e përcakton qartë vazhdimin e kontratës në bazë të performancës.

**Gëzim Sveçla** Po, veç janë 3 kategori, ti e din shumë mirë, një 15 dhe 15 deri 99, si është kushti 15 deri 99.

**Doruntinë Maloku** dha sqarime për çështjet e cekura nga parafolësi.

**Gëzim Sveçla** E qysh e dimë ne si e ka pasur performancën kur nuk e kemi parë raportin, se ne e kishim vlerësuar pozitiv ose negativ, po problemi që nuk e kemi parë raportin hiç.

**Doruntinë Maloku** bëri të ditur se raporti i performancës, me sa unë kam njohuri, sepse ka ardhur prej Zyrës ligjore, nuk po dua me marrë përgjegjësi me fol 100%, po ka ardhur në dhjetor, kur e kemi përfunduar procedurën e parë edhe e kemi diskutuar atë çështje të raportit edhe atëherë.

**Gëzim Sveçla** tha, po mirë por ne jemi në prill, dokumentacioni për këtë pikë të rendit të ditës na ka ardhur.

**Leutrim Retkoceri** u shpreh se dy çështje janë me rëndësi për pikën e 5-të, e para kaloj, koha që mundet me u bërë plotësim-ndryshimi nëse jepet në shfrytëzim, a po nëse bëhet vazhdim i dhënies në shfrytëzim të pronës. Kjo u dashtë me u ngritur në fillim drejtoreshë, çështje e ndryshimit të titullit të pikës të rendit të ditës. Kjo duhet me u përgatit për seancë, me u bërë propozimi për ndryshim të titullit.

**Doruntinë Maloku** tha në seancë domethënë.

**Leutrim Retkoceri** tha seanca e voton e para, e dyta duhet patjetër me qenë raporti i performancës, pavarësisht se kush e ka bërë ashtu siç thirret ligji, se duhet me pa edhe asamblistët e tjerë atë raport. Mendoj që duhet me qenë një arsye mbi bazën e ndryshimit të titullit. Pse titulli po ndryshohet në vazhdim të kontratës dhe jo dhënie në shfrytëzim, edhe atë arsyeshmëri Zyra ligjore po besoj në bazë të ligjit mundet me bërë edhe me ia dërguar si

material shitesë pikës, në mënyrë që momenti kur votohet edhe kalon, mos të ketë kthim prej instancave tjera më të larta që pika nuk është në harmoni dhe në përputhje me ligjin.

**Kryesuesi** konstatoi se u përkrah që **Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Qendrës sociale edukative “Don Bosko”** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

### **Pika e gjashtë**

**Propozim-vendimi për fillimin e procedurave të konsultimit publik për Projektregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01. nr. 110-1203, dt. 16.6.2010**

Lidhur me këtë propozim në pika të shkurta dha sqarime Izet Sadiku, duke çekur se rregullorja që është e miratuar në vitin 2010, të cilën fatkeqësisht Komuna nuk e ka zbatuar asnjëherë, ku në nenin 15 e ka thënë orari ka qenë 7 në 10 kur i jepet obligim drejtorisë me bërë kujdestarinë. Pas disa takimeve me qytetarë, kemi kuptuar se nuk ka barnatore kujdestare në Prishtinë, e patëm shikuar, është e vërtetë se nuk ka pasur, ka pasur që punojnë në 3 në 4 edhe e kemi filluar atëherë me Odën e Farmacistëve të Kosovës me biseduar. Si temë ka qenë shkurti i vitit 2023. Në takim ka ardhur ish-kryetari i Odës, i cili ka thënë po drejtor, kemi shumë interes. Duke pasur parasysh se Komuna nuk ka kapacitete për këtë fushë, ne ia kemi lënë njëfarë forme këtë të drejtë që e ka bërë një ekip. Ai ekip që ka qenë prej 5 anëtarëve prej të cilët kanë qenë një zyrtar ligjor dhe një ka qenë zyrtarë i Drejtorisë, ndërsa tjerët kanë qenë farmacistë të Odës, ka bërë një debat, ka bërë një propozim 6 muaj ditë dhe është bërë një debat publik. Debat i publik vitin e kaluar është bërë, më 8 gusht, ku ka qenë një numër i madh i barnatoreve, së paku këta që punojnë, kanë dhënë qëndrime për orare, propozime që nuk ka pasur vërejtje, për arsye se ky grupi punues sugjerimi i tyre ka qenë që orari që është në rregulloren e 2010-ës, u zvogëluar për një orë. Është debatuar me krejt përfaqësuesit që janë ardhur në takime nuk ka pasur vërejtje. Ka filluar me 4 shtator, është miratuar, më 23 tetor ka filluar aplikimi. Në fillim, pas një muaj dite, në fund të nëntorit, më 23, unë prapë i kam thirrur të gjithë partnerët, disa barnatore që kanë pasur probleme që nuk janë pajtuar me këtë orar, kanë menduar që punojnë më gjatë dhe kemi bërë një grup punues, me propozimin e Odës, ku kanë qenë edhe barnatoret që nuk janë pajtuar me këtë orar edhe ato që janë pajtuar. Ky grup e ka bërë një propozim, më 22 dhjetor, janë pajtuar të gjithë që propozimi i ri është rritur për një orë orari i barnatoreve të punës, ka qenë 7 me 9 u bë 8 me 11, d.m.th. me një orë është rritur, është bërë 11 prej 7-ve. Kemi laramani, ku një komunë e ka që punon deri 12, një komunë deri 10 ose 11, edhe është plus një prej çështjeve që ka qenë besoj problematikë që ka besuar grupi e që është adresua edhe në asamble, ka qenë që kjo kujdestaria në krejt Prishtinën ka qenë që është edhe sot, të mos zbatimit të rregullores, ka qenë e papranueshme, pse pas orës 10 me punuar dikush në Bardhosh ose në Hajvali e në QKUK mos me pasur, nuk ka qenë e pranueshme, edhe është bërë propozimi i fundit që ka qenë, që është afuar 22 që 5 barnatoret kujdestare kanë me qenë një fokus të veçantë tash për kujdestari, dy prej tyre kanë me qenë në perimetër të QKUK-së, që i bie diku prej fundit të rrugës B deri te Rrethi i Flamurit, ai perimetër dy, një me qenë me perimetër të QKMF-ve që janë kujdestare, që i bie në Dardani, Xhemal Ibish dhe QKMF, që i bie t'i del në ora 11 me punuar e pas orës 11 me punuar vetëm barnatoret që janë afër QKMF-së dhe është dalë që është i domosdoshëm. Unë e di që ka pasur vërejtje, unë mendoj që duhet me bërë ndryshe edhe për informimin e qytetarëve, për me bërë ndryshe. Ne e kemi diskutuar këtu, për me e pasur një qasje më ndryshe, është i vetmi kryeqytet edhe disa qytete në Kosovë kanë kujdestari, i vetmi kryeqytet në Evropë që nuk ka kujdestari, i vetmi jemi. Jemi munduar me adresuar qysh edhe e kemi diskutuar, pas një muaji është miratuar në Kuvend një ndryshim, po që fatkeqësisht nuk ka mundur me u zbatuar, për arsye mbas miratimit të saj e ka kthyer që nuk është bërë debati publik edhe duhet me shkuar me debat publik. Kështu që kemi pasur ankesa, por më së shumti vërejtje, ku këto vërejtje jam i gatshëm me i pranuar se kam qenë drejtor dhe e kam parë që kam obligim për qytetarët, a duhet me u bërë ndryshe, mendoj veç e kemi bërë për me u bërë ndryshe. Ky debat jep mundësi me i provuar krejt ato lëshime që i kemi pasur për një muaj ditë dhe me bërë një orar që ka me qenë i pranueshëm së paku për këtë periudhë, derisa Ministria merret me nivel të Kosovës, edhe pse unë e kam një draft të Ministrisë, që është i propozuar orari 8 me 8, që është shumë më i vogël sesa që e kemi sot, për arsye e kemi përmendur, po ju them edhe juve, orari i Beogradit, i Zagrebit edhe i Tiranës është 8 me 8, kryeqytetet e rajonit vetëm Shkupi e ka 8 me 10, në asnjë qytet tjetër në Evropë nuk e gjen



që ka orar pas orës 8 kujdestari në barnatore, mirëpo Kosova ka specifikat e veta. Ne e dimë që shpesh kemi mungesa të barnave nëpër zyrat shëndetësore dhe nevojat që qytetarët me ble janë shumë më të mëdha sesa që mendojmë ne, edhe kjo e detyron që këtë fazë ne me e bërë një orar që shkon deri në 11, me e propozua.

Unë jam i vetëdijshëm që orarin nuk mund ta rregullosh këtu, se nuk është përgjegjësi e orarit, por me këtë orar krijohet parakushte dhe njëfarë rregulle ministrisë, që Inspektorati me e ditë se si e ka orarin. Sigurisht që unë e kam parë që edhe Komuna merr obligime shumë me këtë çështje i dalin detyrës, se inspektorati ka me pasur shumë më shumë punë.

**Kryetari** theksoi se prapë një problem kyç që e kam parë edhe po e shoh faktikisht, që nëse një familje apo një dikush shkon në spital edhe spitali nuk ka mundësi me i ofruar të gjitha barnat, po i thotë familjes dil blej, nuk ka rregullore që i ndihmon qytetarit. Nuk mundemi me bërë një rregullore, e cila e cakton periudhën kohore deri kur mundesh me blerë barna. Nëse spitalet tona i kanë të gjitha barnat në spital, sepse rrezikojnë jetën e qytetarit, tash qysh vet rregulluar, sistemi është që spitali nuk i ka pasur, ke dalë edhe i ke blerë, i ke gjetur diku. Për fat të keq, unë mendoj që nuk mundemi me rregulluar diçka përbrenda kryeqytetit sot përkundër faktit që dëshirojmë, a po jemi të fundit, a po të vetmit që se kemi. Nëse ne qytetarit që i nevojitet ndihma shkon në spital edhe nuk i ka mundësitë për me marrë shërimin, apo me marrë atë mjekimin, përkundër faktin edhe mungojë barnat në spital. Tash për këtë arsye ishte dashtë, derisa ajo nuk rregullohet edhe kjo nuk mundet me u rregulluar, kot ne mundohemi me rregulluar, e kemi parë edhe vetë qytetarët kanë nevojë, kështu që pa e rregulluar këtë spitali në nivelin primar apo nivelin sekondar, domethënë aspektin e barnave me qenë në rregull, me qenë në spital aty ku edhe je shkuar në emergjencë kot mundohemi ne.

**Gëzim Sveçla** pyeti kryetarin se a je për të mos bërë rregullore.

**Kryetari** theksoi se unë po e them rregullorja nuk ka efekt, nëse një qytetar shkon në spital edhe spitali thotë dil shko blej barna se nuk kemi ne!

**Gëzim Sveçla** u shpreh se ky është një problem i kamotshëm, po pajtohem plotësisht me kryetarin, po që është duke u përmirësuar. Për shembull, sivjet i ke 60 milionë për listën esenciale të barnave, që është një buxhet shumëfish më i madh sesa buxhetet e viteve paraprake që kanë qenë.

Problemi nuk është krejt te rregullorja, le të na thotë drejtori sa barnatore janë dënuar për mosrespektim të orarit të punës prej që hyrë kjo rregullore në fuqi, se janë duke punuar me rregullore, ne nuk e dimë që APL-ja a e ka krthyer apo nuk e ka kthyer vendimin.

**Kryetari** theksoi se problemi sot është që e kemi parë se jo të gjitha farmacitë i kanë të gjitha produktet që u nevojiten personave me nevojë, edhe tash nëse ne e krijojmë një rregullore, ku themi njëherë e ke ti, njëherë ti, njëherë ti, iu bie dikujt që nuk e ka atë produkt që i nevojitet qytetarit edhe për këtë arsye nuk funksionon sistemi.

**Izet Sadiku** tha se domethënë që kjo ka qenë se është ndryshuar, nuk ka hyrë në fuqi, kjo e dyta që po thotë kryetari, domethënë në rregulloren e dytë që është, këto që janë adresuar kujdestari, më nuk ka me pasur Vranjevci ose në Hajvali, kanë me qenë kujdestari dy barnatoret që janë të mëdha, që janë të furnizuara afër QKUK-së, për arsye se ne e dimë që afër QKUK-së, ai në Vranjevci pe marrim ose ai në Hajvali nuk ka nevojë me i marrë pare QKUK-së se nuk i shkon kurrë atij në Hajvali.

**Gëzim Sveçla** shprehu mendimin se kjo po i bie që kemi njëfarë favorizimi ndaj atyre që e kanë lokacionin më të mirë.

**Kryetari** tha se këtu tash ne ose duhet me planifikuar, kjo nuk është faktikisht favorizim në aspekt që ne po dëshirojmë me i favorizua, por po e bëjmë domethënë një propozim që funksionon, brenda kushteve sot, cili është propozimi që funksionon, është i fundit, domethënë nuk është aspekt favorizim, por është me ndërlidhur me gjendjen ku jemi sot si shoqëri, na nevojitet me e marrë këtë.

**Izet Sadiku** u shpreh se pas bisedës që e kam pasur tash me shumicën në grup që janë, ata që janë afër spitalit kanë thënë se kanë interes, sepse ata edhe ashtu deri 12-1-2 i kanë mbajtur, a kjo që është cilëndo pjesë edhe ne Hajvali me qenë nuk ka llogari me mbajte pas 12-ve se nuk ka, i ka 3 pacientë, e ne QKUK ka, se ka fluks të pacientëve sepse vjen krejt Kosova në QKUK. Prandaj ne e kemi bërë këtë propozim, është pas debatit që kemi bërë me barnatoret jo me neve, edhe grupi punues që ka qenë, ku kanë qenë përfaqësuesit e disa barnatoreve që janë afër QKUK-së, ata e kanë pasur një propozim, që afër QKMF-ve me qenë kujdestari se mbas 11-ve nuk ka logjikë me pasur në lagjet ku nuk ka mjek, se nuk ka emergjenca mbas 11-ve, nëse patjetër është emergjent, ai duhet shkuar te mjeku e mjeku ia përshkruan barnat.

**Gëzim Sveçla** tha, d.m.th. drejtor propozimi tash për tash është që me qitur rregulloren për diskutim publik. A bën që këtij propozimi me ia shtuar, për shembull ti me e caktuar një diskutim publik, me e thirrur edhe Odën e Farmacistëve, me i thirrur edhe prej Ministrisë së Shëndetësisë edhe prej Drejtorisë së Inspektionit, patjetër se nuk mundet kjo rregullore me u rregulluar pa impenjim të jashtëzakonshëm të Drejtorisë së Inspektionit, ndoshta këtu është edhe kryetari, edhe prej asamblistëve kush ka dëshirë, edhe me shikuar, cila është mundësia më e mirë.

**Izet Sadik** tha pohoi se ky është qëllimi. Ai pati një rekomandim, duke thënë ne çka mund të bëjmë me këtë rregullore që ka qenë, në qoftë se nuk e di a është ajo që ka qenë e fundit, mund ta heqim orarin 7 me 9 në rregulloren e 2010-ës është 7 me 10, me kthye këtë orarin 7 me 10.

**Shegë Beqiri** tha se problemi më i madh ka qenë informacioni, edhe ne nëse nuk bëjmë diçka me informacion kot, askush nuk i ka ditur planet.

**Izet Sadiku** theksoi se qëllimi është se me këtë debat që po e hapim ne, po e hapim një rregullore, kjo nuk do të thotë se po i qesim në pah krejt çështjet edhe me i hequr krejt.

**Gëzim Sveçla** u shpreh se gjatë këtij diskutimit publik, këtu mund të lindin ide të mira, të cilat mund të inkorporohen në rregullore, kjo nuk na pengon ligjërisht, se kjo prapë do të kthehet në Kuvend për votim.

**Izet Sadiku** tha se duhet gjete shoqata të pacientëve, që nuk kanë qenë, domethënë se shoqata e pacientit thotë nuk kemi gjetur shoqata, duhet me i angazhuar shoqatat e pacientëve, qytetarëve, me e thirrur një grup se ata kanë pasur sugjerime.

**Kryetari** u shpreh se për secilin qytetar duhet me ditë që e kanë një pikë, një pikë duhet me u ditë, nëse është një pikë që e dimë që është 24 orë, atëherë shpëton jetë, tjerat janë rezultat qysh vendosim ne në bazë të rregullave.

**Gëzim Sveçla** shprehu mendimin se ne duhet me e pasur veç një prioritet, jo veç një prioritet por prioriteti kryesor duhet me qenë furnizimi i pacientëve, me pasur ata ku me u furnizuar, kjo është kryesorja domethënë, jo me shikuar fort interesin e barnatoreve, por është qëllimi që qytetarët mos me pasur problem me i siguruar barnat, kjo është esenciale.

**Izet Sadiku** theksoi se në Bardhosh e kemi bërë prej tetë orëve punë në dymbëdhjetë orë, e kemi bërë një laborator se nuk ka pasur.

**Kryesuesi** tha drejtor, unë besoj edhe këto kur i bëni, i bëni në bazë të numrit të popullatës, rreth dymbëdhjetë mijë i ka veç Bardhoshi edhe nuk punon, ka punuar të shtunën, pse e keni ndërprerë, se të shtunën ka punuar.

**Izet Sadiku** tha e shohim, bile të shtunave e bëjmë njërin ndërrim para 8-ve.

**Jeta Rafuna** tha diçka dëgjim publik, le t'i sjellin edhe njëherë të japin krejt vërejtje, tash vërejtje krejt i kemi, ankesa kemi.

**Leutrim Retkoceri** bëri të ditur se ka dy komente. Drejtor, nisma për rregullore përveç dëshirës edhe vullnetit, domethënë ka plot procedura që janë të kapërcyera shpejt e shpejt, që t'i kanë krijuar disa pasoja. Procedura së pari, konsultimet publike, këto dëgjimet publike, target duhet pas qytetarin e jo bizneset. D.m.th. do të thotë kur i merrni komentet, ti duhesh me insistuar, është dashtë me thirrur qytetarë e jo biznese më shumë, për me qenë më afër qytetarëve, se barnatorja edhe plot biznese u shërbejnë qytetarëve. Komuna duhet me qenë kujdestare e shërbimit të qytetarëve, pastaj gjithqysh të bizneseve, por së pari qytetarëve. Këtu në qendër nuk ka qenë qytetarë, kuptojë drejt ku është gabimi, e para. E dyta, kjo vetëm rregullore nuk është, kjo ka kufizim të orarit, rregull të ri nuk qet, tash kjo është një rregullore që brenda rregullores i ka disa sektorë tjerë. Problemi tjetër, kush e merr përgjegjësinë, ju thatë prej dhjetorit e keni nisur me bë ndryshime, në shtator kur ka hyrë në fuqi e ne jemi në maj, kjo nuk pritet as në qershor me hy. Për 6 muaj njerëzit janë të kufizuar me orar të shërbimit, a ka përgjegjësi, 6 muaj janë shumë. Po ashtu, tha se unë nuk e di a keni folur me kryetarin, domethënë vizioni i kryetarit ke për këtë temë më korrekt sesa që e ka rregullorja, se ka problem anën profesionale. Pastaj është edhe një problem tjetër, pas kësaj të 6 muajve që Zyra ligjore është dashtë shumë mirë me ju tregu, nuk mundet me ndryshua rregullorja pa dëgjim publik, asnjëherë nuk është ndryshuar, kurrë nuk ka ndryshuar. Problemi tjetër ka përzierje të kompetencave. Komuna mund ta caktojë vetëm orarin, mund ta kufizojë këtë, mirëpo Komuna nuk e ka të drejtën e Inspektoriatit Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë, që mundet me inspektuar një barnatore, çfarë barnash është duke mbajtur, a është duke i mbajtur barnat esenciale, a është duke i mbajtur disa që janë të rëndësishme, a kanë afat a nuk kanë afat, Komuna nuk e ka këtë kompetencë, Inspektorati nuk ka kompetencë.

Ne kemi bërë shkelje të të drejtave të pacientëve, ua kemi kufizuar mundësinë me marr, me javë e kemi dërguar qytetarin e Prishtinës, qytetarin e Kryeqytetit e kemi dërguar në Graçanic, në Fushë-Kosovë, e ke qitë prej

menduar, pa e analizuar edhe punën e informimit, Në fillim ka qenë si kanë mu informuar, p.sh. plaku që shkon aty si ka me u informuar, si ka me marrë vesh ai ka qenë problemi më i madh, plus edhe nëse e informon ti kujdestarin ja lenë, me çfarë shkon dikush q nuk ka veturë.

**Izet Sadiku** i dha disa sqarime lidhur me këto çështje.

**Jeta Rafuna** tha mund ta lëmë ashtu si ka qenë, ne rregull, por kam pasur rast personal qe këto s'kanë funksionuar asnjë kujdestari natën.

**Leotrimi Retkoceri** tha se ti në dhjetor e ke bërë ndryshimin, pa e dërguar në dëgjim publik.

**Izet Sadiku** theksoi se neve na kanë thënë shkoni në Zyrë ligjore, është ne rregull . Unë si drejtor i Shëndetësisë i pranojë sugjerimet, vërejtjet, lëshimet qe i kam bërë, qëllimi ka qenë me bërë një kujdestari, me e ditë që Prishtina ka një barnatore ose 5 barnatore kujdestare deri ne mëngjese.

**Kryesuesi** konstatoi se u përkrah **Propozim-vendimi për fillimin e procedurave të konsultimit publik për Projektregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01 nr. 110-1203, dt. 16.6.2010** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### **Pika e shtatë**

#### **Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për dy familje strehuese, Sinani dhe Selmani**

Lidhur me këtë propozim-vendim në pika të shkurta dha sqarime **Adelinë Sahiti**, drejtore, duke cekur se kemi të bëjmë me një nga format e mbrojtjes sociale, sigurisht janë edhe familjet strehuese, fëmijë të cilët nuk kanë kujdes prindëror nga rrethanat e ndryshme qe i ka marrë shteti dhe janë në dorë të shtetit. Meqë kjo është forma e vetme me të cilën ne mund të sigurojmë që këta fëmijë të kenë një mirëqenie , kanë një kujdes nga këto familje strehuese te cilat sigurisht janë të trajnuara, të certifikuara, dhe të licencuara edhe nga niveli qendrorë. Këto familje mbajnë fëmijë mbi moshën 18-vjeçare, fëmijë me aftësi te kufizuara, 2 familje, dhe çdo ditë na telefonojnë se çfarë po bëhet, kështu që janë të njohur. E keni pasur edhe arsyetimin në Qendrën për Punë Sociale. Pse duhet t'i ndihmojmë këto familje, pse duhet t'u ofrojmë mbështetjen tonë si Kryeqytet? Pra, kërkoj që të votohet ky propozim –vendim, kështu që uroj dhe po besoj se si çdo herë kemi qenë një zë në këtë drejtime dhe kësaj radhe KPF-ja do të na mbështet që në seancat në vazhdim të votojmë për këto familje t'i marrim mjetet, sepse është bërë shumë gjatë.

**Nora Kelmendi** pyeti a ka edhe familje tjera që kanë nevojë për mjete financiare, apo vetëm këto dyja ju kanë mbetur.

**Adelinë Sahiti** u përgjigj për pyetjen e parashtruar nga parafolësja.

**Mirsad Vitija** pyeti drejtoreshën, a i keni gjetur ju apo ju kanë gjetur juve ata, po mendoj identifikimin e tyre.

**Adelinë Sahiti** u përgjigj, ata fëmijë i kemi ditur kaherë si Qendër për Punë Socialë qe kemi fëmijë pa përkujdesje.

**Kryesuesi** konstatoi se u përkrah **Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për dy familje strehuese, Sinani dhe Selmani** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### **Pika e tetë**

#### **Propozim-vendimi për mbështetje financiare të shërbimeve sociale për fëmijë me aftësi të kufizuara**

**Gëzim Sveçla** pyeti se a keni marrë e-mail të gjithë, unë i kam takuar ata t "Hendikos"-it.

**Adelinë Sahiti** tha se kam takim me ta, janë duke më pritur.

**Gëzim Sveçla:** tha se shumë mirë qe janë duke të pritur, ti vetëm gjeje mënyrën qysh kemi me i nda paret.

**Kryesuesi** tha se edhe unë i kamë takuar ata.

**Adelinë Sahiti** tha se janë te gjitha kategoritë sociale qe ne i mbështesim, janë të ndjeshëm dhe kanë nevojë në baza ditore, baza mujore që shteti i mbulon, këto janë edhe te "Hendikosi". Unë kam pasur takime edhe me Afrimin dhe Afërditën, kamë shkuar, unë kamë treguar se çfarë mund të bëjmë si kryeqytet.

Të jemi pak e qartë pse e keni sjellë si pikë të rendit të ditës, por çfarë kërkon "Hendikos" ne ketë raste, dua të jem plotësisht e sinqertë me ju. Ju e dini se pas disa viteve, më në fund është funksionalizuar Qendra për Sindrom Doven dhe Autizem, lajm shumë i mirë, lajmë që na ka gëzuar pa masë të gjithëve, sepse ka pasur shumë vështirësi ata me i paguar, por më në fund arritëm ne si Drejtori e Mirëqenies Sociale, që me mbështetjen e kryetarit që t'a marrim përsipër komunalinë, është objekt goxha i madh. Si objekt ka goxha shpenzime për me mirëmbajtur, por për neve është e rëndësishme që fëmijët me Sindrom Doven dhe Autizem të marrin shërbime si të gjithë fëmijët e tjerë çfarëdo qoftë aftësi të kufizuara, fizike, mendore, apo tjera. Po ashtu, me Afrimin ne kemi biseduar, edhe me të e kamë shumë mikë dhe e ka një kauzë shumë të rëndësishme pothuaj si të gjithë, pa asnjë dallim, si të gjithë te tjetër është "Hendikosi", është shoqatë themeltare e aftësisë së kufizuar në Kosovë dhe e çmojë shumë kontributin e tij, por jam kapë pakë ne ketë pikë me thanë pse ju po e mbështetni autizmin dhe Sidromin Daun dhe neve jo. Ju kamë thanë eja dhe apliko për subvencione, ju kam thënë që gjithmonë shumën maksimale e ke.

**Gëzim Sveçla** tha se nuk mjafton ajo shumë 15 mijë euro, nuk mjaftojnë për "Hendikos"-in.

**Adelinë Sahiti** u shpreh se e kuptojmë por është e vetmja mundësi.

**Gëzim Sveçla** tha se nuk është e vetmja.

**Adelinë Sahiti** tha se ne përmes thirrjeve e kemi mbështetur, ju e dini që ne e kemi rinovuar në tërësi "Hendikos"-in në shumë e shumë forma.

**Gëzim Sveçla**, ju e dini që në dhjetor ose në nëntor të vitit të kaluar ne kemi mbështetur shoqata koti me nga 70-80 mij euro.

**Adelinë Sahiti** tha për cilat shoqata po flet.

**Gëzim Sveçla**, krejt koti, organizata jo qeveritare, bile edhe SHPK kemi, që ky Kuvend komunal i Prishtinës ne propozim të ekzekutivit, pjesë e të cilit ti je, pa marrë parasysh tash bindjet tua politike, e majtë apo çfarë je, është e pafalshme për Kuvendin komunal të Prishtinës që 4 muaj personat me aftësi të kufizuara, nuk mundën me i marr shërbimet e tyre, mungesë 42 mijë euro që Kuvendi komunal i Prishtinës nuk i ndan.

**Adelinë Sahiti** pohoi se nëse i ndajmë 42 mijë euro nga Drejtoria e Mërqinjës, nga kategoria e subvencioneve, do duhej ndoshta problem i madh, për shkak se ne tash veç sa e kemi hapur thirrjen, dhe kanë me aplikuar me dhjetëra organizata, si herën e kaluar, mbi 80 organizata kanë aplikuar, që ofrojnë shërbime direkte çdo ditë.

**Gëzim Sveçla**: tha se e ka parë e-malin se ju janë drejtuar edhe ty drejtoreshë, është shumë e qartë që shuma e mjeteve e cila subvencionet nga Drejtoria, nuk mjafton për mbarëvajtjen e punëve të "Hendikos"-it, është turp për Kuvendin komunal të Prishtinës, të cilit i teprojnë 50 milionë, e mos me gjetur një metodë qysh me subvencionuar. Nëse pajtohesh me ne, të lutem veç e gjënë metodën me drejtuar me Kryetarin, i cili ka shprehur gatishmërinë e tij, dhe me Zyrën ligjore, cila është mënyra që ne me ua përmbushur kësaj radhe këtë çështje, për pjesë tjera ndoshta duhet shikuar kur bëhet ndarje buxhetore në shtator.

**Adelinë Sahiti** theksoi se kjo është nëse s'kemi ligje për vetëqeverisjen lokale, ajo është te Ligji për financa publike, gjë e cila na nxjerrë shumë telashe tjera për kontraktim të shërbimeve sociale. Sikur të ishin kontraktuar shërbimet sociale, ky diskutim nuk do të ishte më, sepse e kishim ditë sa është mirëfilli kosto totale për një fëmije dhe ti si Komunë i kishe kontraktuar përmes prokurimit, po ketë nuk kam mundur ta bëj.

**Gëzim Sveçla** shprehu mendimin se nuk ka një asamblist i Kuvendit të Prishtinës, i cili kishte me kundërshtuar gjetjen e një mundësie ligjore për me i ndihmuar këto kategori. Prandaj ju jeni ekzekutivi, i cili duhet me propozuar zgjedhje, të cilat Kuvendi komunal i voton. A duhet me ndryshuar rregullore a çka duhet bërë është çështje të cilën ju duhet ta ndryshoni.

**Adelinë Sahiti**, jemi të gatshëm dhe e kemi vullnetin e duhur për gjithë secilën dhe po besojë që 2 vite e 4 muaj kemi dëshmuar në baza ditore.

**Gëzim Sveçla**, e qysh që 4 muaj, kur ata fëmijë nuk po mundën me marrë shërbime publike, po thua e kemi ditë çka keni dëshmuar, marre është kjo.

**Adelinë Sahiti**, tha ne kemi dhënë, d.m.th. projektet tona do të zgjasin për fëmijë të Prishtinës, a e dinë që në "Hendikos" nuk shkojnë veç fëmijët e Prishtinës.

**Leutrim Retkoceri** shprehu mendimin se nuk ka nevojë me bërë problem një çështje, për të cilën si propozim, momentin që vjen në Kuvend dhe kalon mbështetjen e grupit të PDK-së, do të ketë kjo pikë dhe pastaj ky vendim

është obligues jo për ty drejtoreshë, qetësohu dhe mos e merr me stres, nuk ke nevojë, por është obligim për Kryetarin e Komunës dhe për buxhetin e Komunës. Ajo ekzekutohet, nëse nuk ekzekutohet me vullnet, ekzekutohet me përmbardim, edhe kështu mos e bëni, ka mënyra ku gjinden paratë, janë edhe subvencionet edhe te Kryetarit, edhe te Komunës dhe të drejtorive, është punë shumë e thjeshtë.

**Nora Kelmendi**, desha t'i tregoj, se po thotë të gjitha mënyra, se ekziston subvencionimi pa thirrje publike, që i bie me bërë nga dhjetori ose nëntori, nuk e di ku i kemi dhënë edhe SHPK-ve mjete, e përmendi edhe Gëzimi, kështu që Kryetari mundet me e krye ketë punë, po mendoj që është thirrja, pa thirrje publike që e subvencionon dhe kryhet, ekziston mënyra vetëm a ekziston vullneti.

**Gëzim Sveçla** theksoi se po i bie që nuk ke dashtë Adelina që 4 muaj, a po sheh që ka mënyra plot, po nuk ke dashur.

**Adelinë Sahiti**, unë po të them, pasi që paske komunikim, se e din sa herë kam shkuar në "Hendikos" dhe sa herë i kam thirrur për sa persona me aftësi të kufizuara po flet o Gëzim.

**Gëzim Sveçla** tha për 200 persona, të cilët marrin në Qendrën e re dhe 4 muaj ditë nuk ke qenë në gjendje me gjetur për këta persona 800 euro, është kosto minimale e një familje që e mban një person me aftësi të kufizuara me i marrë shërbime çdo tri ditë, terapi fizikale që iu duhen, është e tmerrshme, e turpshme se çfarë po ndodh në Komunë të Prishtinës.

**Kryesuesi** konstatoi se u përkrah **Propozim-vendimi për mbështetje financiare të shërbimeve sociale për fëmijë me aftësi të kufizuara** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### **Pika e nëntë**

**Propozim- vendimi sipas të cilit duhet të mirëmbahen të gjitha hapësirat publike ose private, vizualisht të dukshme nga rruga apo të cilat ndikojnë në mjedisin përreth, në pamjen vizuale dhe të pastër të Kryeqytetit.**

**Kryesuesi** tha drejtor a e kemi analizuar a e keni gjetur që ka qenë një ditë në rregullore, më herët që kjo

**Bekim Brestovci** u shpreh se e kemi analizuar rregulloren dhe fatkeqësisht rregullorja jep një zbrazëtim, të cilën po mundohemi me plotësuar, me mbuluar, tash thirret veç si zona në nenin 116-117-118, mirëpo pastaj te masat ndëshkimore dhe ju shtohet njësi me ndëshkuar personat fizikë dhe juridikë, të cilët nuk i ndër marrin masat e tilla për pastrimin e oborreve, të shkurreve, kositjen e barit, si dhe ndotjen sipërfaqësore. Kështu që jemi dakorduar me e lënë si vendim, sepse përkundër faktit që është me rregulluar me një volum bukur të mirë me shumë se 160 nene, prapë është përvjedhur kjo pjesë dhe nuk është e mbuluar, ne kemi filluar me punuar tash me ketë qeshje, infrastrukturën, kontejnerët e rinj me operatorët ekonomikë për tentativa për blerjen e kamionëve të ndërmarrjes "Pastrimi", por po përpiqemi që dispozitat ligjore krejt t'i kemi, që t'i kemi në dispozicion, që të na garanton pastrim 100%.

**Gëzim Sveçla** tha se baza ligjore e këtij vendimi cila është, baza ligjore lart me çfarë je thirrë.

**Bekim Brestovci** dha sqarime.

**Gëzim Sveçla** shprehu mendimin se duhet bërë plotësim-ndryshim e rregullores dhe me i përfshi këto që ju i kërkoni me rregullore, se nuk bahet me vendim kjo, nëse nuk i përmban rregullorja, nëse rregullorja kish me përmbajt diçka, ti mundesh me marrë një hap nënligjor, vendim që është me fuqi më të ulët nënligjor që është sesa rregullorja, por që mbështetet në rregullore. Tash ne për çështje të pastrimit i kemi një farë, si me thanë një kushtetutë që është rregullorja ne ketë rast, që duhet me iu dhënë asaj një përmbajtje, paramendoj që duhet me u bërë përmes plotësim-ndryshimit. Nuk kemi asgjë kundër këtyre dhe këto janë shumë në rregull, por mendoj se do aspekte ligjore duhet me u bërë përmes plotësim-ndryshimit të rregullores.

**Bekim Brestovci** tha se kjo rregullore që e rregullove ishte shumë e mirë.

**Gëzim Sveçla**, shumë e mirë është, e kemi votuar krejt atëherë.

**Bekim Brestovci** tha se vetëm masat ndëshkuese për këto kategori nuk ishin të parapara për këto kategori, nuk e di pse kish ikur, d.m.th. është neni, 100 euro që e parasheh masat ndëshkuese për personat juridikë dhe personat fizikë të cilët janë pronarë ose të bizneseve ekonomike ose të bizneseve.

**Jeta Rafuna** tha në rregull jemi kryesues, vetëm të shikohen edhe një herë anët ligjore, sepse sa për neve e votojmë, nuk ka problem, vetëm këqyr me plotësim-ndryshim të rregullores, apo me vendim.

**Leutrim Retkoceri**, drejtor, kjo si ide është shumë e mirë, pajtohem me ju, vetëm se është një rrezik që sikur Izetit, veç vendimi i Kuvendit pa u përfshirë në diskutim publikë, për me u mbështetur në një organ ose në një rregullore, një hapë më të lartë se vendimi, atëherë kthehet nga MAPL –ja se sa zbatimi i saj është me problem, sepse inspektori nuk mundet me lëshuar vendim, por kur të lëshoj gjobën duhet me me pa se në bazë të cilës rregullore po e lëshon atë gjobë, duhet me thënë vendimi, e ai vendim d.m.th. e ka një numër, që është tani problematik me pas implementimin sikur edhe bazat ligjore që kish qenë e rregullt dhe i kishte aprovuar MAPL –ja, aty është, ndërsa sot sa i parket gjobave, kur është hartuar rregullorja nëse të kujtohet, ka pasur një interpretim të Zyrës ligjore dhe ata duhet me verifikuar se kush është mandatori me gjobitë, dhe e kanë lanë në inspeksion dhe nuk është përfshirë pjesa tjetër e gjobave, se u kanë edhe ideja se nëse Parking Prishtina e gjobitë dikë që e lë makinën keq, atëherë pse nuk mundet kompania e pastrimit me gjobit një klient të saj që i gjuan mbeturinat jashtë kontejnerit. Në atë kohë nuk u pranua kjo farë pune prej Zyrës ligjore, për shkak se mandatar ka qenë inspektorati, ndërsa unë mendoj se nuk ka qenë krejt qashtu, se deri sa mundet Parking Prishtina, ishe dashtë edhe një ndërmarrje tjetër me gjobitë për me hequr fluksin e punëve nga inspektorati. Por, Inspektorati a me shikuar kush nuk po i mirëmban kopshtet. Tash kjo e ka edhe një çështje tjetër që është mirë me verifikuar të drejtat e pronës private, se njeri brenda pronave private në dashtë e lë barin më lart, në dashtë e lë më poshtë.

**Bekim Brestovci** u shpreh i pajtimit, faktikisht shumë mirë u përfshi çdo gjë, mirëpo vetëm gjoba ishte bërë një lëshim tepër i vogël, mendova se mundem me rregulluar me një vendim, mirëpo pajtohem plotësisht me ju që mundemi me shkuar me propozim-vendim të ndryshimit të rregullores.

**Gëzim Sveçla** tha se këtë mund ta sillni nesër para seancës dhe e qesim ne diskutim publik.

**Leutrim Retkoceri**, e ndryshojmë titullin si të Doruntinës dhe nuk humbim kohë me këtë seancë.

**Kryesuesi** konstatoi se u përkrah **Propozim- vendimi, sipas të cilit duhet të mirëmbahen të gjitha hapësirat publike ose private, vizualisht të dukshme nga rruga apo të cilat ndikojnë në mjedisin përreth, në pamjen vizuale dhe të pastër të Kryeqytetit**, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

## **Pika e dhjetë**

### **Diskutim lidhur me zyrtarizimin e Parkut memorial “ Të Pagjeturit”**

**Gëzim Sveçla** tha se është një propozim që ka ardhur prej Lëvizjes Vetëvendosje, në këtë hapësirën ku është Kampusi Universitar, d.m.th. te Biblioteka Kombëtare është një hapësirë e parkut, e cila qe 2 vjet mirëmbahet në njëfarë mënyrë prej vullnetarëve, dhe ku është e vendosur një guri memorial, të cilin e kemi pjesë të pjesë materiale qe ju kemi dërguar. Më 27 prill është Dita e personave të pagjetur, Në kujtim dhe nderim të personave të pagjetur po kërkojmë nga Kuvendi komunal që ketë emër të cilin e ka te vendosur ne atë guri, ne atë pllakën përkujtimore, tani me zyrtarizuar. Ka pasur njëfarë vërejtje tani me të drejtë, sidomos prej Bahriut, ne kohën kur e patëm diskutuar ketë çështje, e kemi diskutuar edhe në vitin e kaluar kur u afrua ky përvjetor, mos po keqkuptohet dhe mos po llogaritet si persona të zhdukur dhe kriminel të cilët kanë bërë krime në Kosovë, sepse është më se e vërtetë, se një pjesë e policëve serbë janë të zhdukur, megjithatë për me e hequr këtë farë dileme ne parkun e kemi shkruar shumë qartë që iu kushtohet të rrëmbyerve dhunshëm gjatë luftës në Kosovë nga forcat serbe ‘98-’99, që d.m.th. nënkuptohet nga forcat serbe. Qëllimi është me u zyrtarizuar, kjo hapësirë është në një vend interesant Kampusi Universitar, ku është kisha afër, qëllimi është që pastaj eventualisht në të ardhmen qoftë me ndonjë projekt të Komunës ose diçka tjetër, me u mirëmbajtur dhe me shkuar akoma duke u

formalizuar, është me rendis se për shkak se është në qendër të qytetet dhe mendoj se e kemi për obligim ne raport me gjithë të pagjeturit, që të paktën në Prishtinë te kenë një vend, një shenjë, një guri të tyre.

**Kryesuesi** konstatoi se u përkrah **Diskutim lidhur me zyrtarizimin e Parkut memorial “ Të Pagjeturit”** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

### **Të ndryshme**

**Gëzim Sveçla** tha vetëm për çështjen që e pati filluar Jeta me ish-Kryesuesin, për çështjen e rregullores së Kuvendit, nëse mendoj që keni vullnet, mundemi me filluar me diskutuar në atë drejtim, me bërë një rregullore të re për punën e Kuvendit, nëse ka vullnet prej grupeve parlamentare po mendoj, po duhet me e përmend qe me e përmend secili ne mesë te grupeve. Unë nuk po them se sot me marrë njëfarë vendimi.

**Kryesuesi** tha që e diskutojmë këtë çështje më tutje.

Atëherë me kaq po e përfundojmë këtë mbledhje.

Faleminderit shumë!

*Mbledhja përfundoi në orën 12:10 .*

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**

**Kryesues i Komitetit  
Fehmi Kupa**

